



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 3048/7 prot

Datë 04.12.2025

V E N D I M

Nr. 1785 /2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 04.12.2025 shqyrtoi ankesën me:

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F. në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-62411-09-23-2025, me objekt: Materiale Promocionale për nevojat e shoqërisë Illyrian Guard Sh.A, me fond limit 1.487.833 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor Illyrian Guard, Sh.A.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Inpress” ShPK, me Nipt L52122014L,
Adresa:Rr.Siri Kodra, Ish Blloku Magazinat, Tiranë.
- Autoriteti Kontraktor:** Illyrian Guard, Sh.A.
Adresa:Rr Ibrahim Rugova, Tiranë.
- Subjekt i Interesuar:** Operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F, me Nipt L91407009D, *Adresa: Rr. "Mahmut Allushi", Pallati Busa nr 4, me Z Kadastrale 2460, Nr. Pasurie 192/41-N32,Dajt, Linzë, Tiranë.*
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020

“Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjo i relatorin e çështjes, shqyrtoi pretendimet të ngritura në ankesë, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 24.09.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-62411-09-23-2025, me objekt: Materiale Promocionale për nevojat e shoqërisë Illyrian Guard Sh.A, me fond limit 1.487.833 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor Illyrian Guard, Sh.A.

II.2. Në datë 06.10.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Nga verifikimi në sistemin e prokurimit elektronik (SPE), si dhe referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, rezulton se në datën 15.10.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike si më poshtë:

1. Filara ShPK	me ofertë	1,056,361	Lekë pa TVSh	Skualifikuar
2. Publicita ShPK.	“	1,266,750	Lekë pa TVSh	Skualifikuar
3. Energita Çekrezi” P.F	“	1,348,500	“	Kualifikuar
4. Inpress ShPK	“	1,427,750	“	Kualifikuar

II.4. Në datën 21.10.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftim fituesi paraprak në Sistemin e Prokurimeve Elektronike.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor është depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/6013, datë 27.10.2025 dhe me Nr. 3048/2025 Prot., date 28.10.2025, nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK, për procedurën e prokurimit “*Procedure e Hapur e Thjeshtuar*” me Nr. REF-62411-09-23-2025, me objekt: Materiale Promocionale për nevojat e shoqërisë Illyrian Guard Sh.A, me fond limit 1.487.833 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor Illyrian Guard, Sh.A.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimmarrjes së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e operatorit ekonomik “Energita Çekrezi” P.F në procedurën e prokurimit sipërcituar.

II.6. Në përputhje me nenin 112 “*Veprimet paraprake*” të Ligjit nr.162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3048/1 prot., datë 29.10.2025, lidhur me pretendimet e ankimuesit

II.7. Nëpërmjet shkresës nr. Nr.1343/34 prot.,datë 30.10.2025, protokolluar me tonën me Nr.3048/2, datë 03.11.2025, autoriteti kontraktor ka paraqitur “*Informacion*” pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Vendimin e KSHA-së lidhur me trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues, duke vendosur mospranim të ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK.

II.8. Nëpërmjet shkresës me nr. 3048/3 Prot., datë 19.11.2025, me objekt: Kërkesë për dërgim dokumentacioni , Komisioni i Prokurimit Publik ndër të tjera shprehet:

[...]Referuar pretendimeve të ngritura në ankesë ndër të tjera ankimuesi argumenton [...]Së Pesti, Mendojmë që në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në DST, dhe Rregullat e prokurimit publik, OE Energita Çekrezi., ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA, AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar përse i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Gjithashtu, mendojmë që OE Energita Çekrezi, nuk ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një Vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha detyrimeve të faturave të energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e prokurimit publik. [...] Komisionit të Prokurimit Publik i lind nevoja të shqyrtojë dokumentacionin e plotë të dorëzuar në mënyrë shkresore pranë autoritetit tuaj kontraktor, në përmbushje të kriterëve të përgjithshme për kualifikim, deklaruar me Shtojcën 9 Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, nga operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F, i renditur i pari.

Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Autoriteti Kontraktor, referuar nenit 26 Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.” të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, kopje, të njësuar me origjinalin të dokumentacionit të plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F. [...]

II.9. Nëpërmjet shkresës nr. 1343/36 prot., datë 21.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3048/4, datë 25.12.2025, autoriteti kontraktor ka paraqitur “Informacion” pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke përcjellë dokumentacionin provues, të dorëzuar pranë autoritetit kontraktor, nga operatori ekonomik fitues “Energita Çekrezi” P.F.

II.10. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ në përputhje me nenin 113 të LPP-së, rezulton se nuk janë dorëzuar argumente nga operatori ekonomik i interesuar, në sistemin e ankesave elektronike.

III

Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Në lidhje me ankesën e operatorit Inpress ShPK, me anë të së cilës kundërshton kualifikimin operatorit ekonomik “Energita Çekrezi” P.F, mbi parregullsi të dokumentacionit të operatorit i kualifikuar i pari,

[...]konkretisht nuk ka plotësuar në formatin duhur: **Formulari Përmbledhës të Vetëdeklarimit**, në shtojcën 9: i cili ka ndryshime si ne forme dhe permbajtje, e rrjedhimisht nuk permbush kriteret per kualifikim

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

Në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur **detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara**. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar përse i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Gjithashtu, mendojmë që OE Energita Çekrezi, nuk ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një Vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha **detyrimeve të faturave të energjisë elektrike**, në përputhje me rregullat e prokurimit publik.

III.1.1. Autoriteti kontraktor ka publikuar shtojcën 9 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*” në dokumentet standarde të tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi si më poshtë vijon:

Shtojca 9

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE)	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	-----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik

(nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Informacione për nënkontraktorin

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
Operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është dënuar për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 76/1 të LPP-së ose ka qenë i dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Personi / personat në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtorit ose mbikëqyrësit, si aksionar ose si ortak, ka ose kompetenca përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, si më poshtë: _____ _____ etj. nuk janë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të përcaktuara në nenin 76/1 të LPP-së ose kanë qenë të dënuar dhe ka kaluar një periudhë 5-vjeçare nga data e ekzekutimit të dënimit, nëse nuk është përcaktuar një periudhë tjetër nga gjykata, sipas parashikimeve të nenit 76 të LPP-së, etj. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

Operatori ekonomik nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv). <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, ose ndodhet në një nga rastet e parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet e energjisë elektrike, për të gjitha adresat e ushtrimit të aktivitetit, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori Ekonomik nuk ka shfaqur mangësi të rëndësishme apo të vazhdueshme në përmbushjen e një kriteri thelbësor të një kontrate të mëparshme me një autoritet ose ent kontraktor apo një kontrate koncesionare që ka çuar në përfundimin e kësaj kontrate. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik nuk është në listën e operatorëve ekonomikë të ndaluar për të fituar kontrata publike në përputhje me nenin 78 të LPP-së. Operatori ekonomik nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë /kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____
Operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij në zbatimin e kërkesave ligjore në fuqi. <i>Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme</i> _____

B: DEKLARATA

Për Dorëzimin e Ofertave të Pavarura

Në cilësinë e përfaqësuesit të operatorit ekonomik, Deklaroj Se: Jam në dijeni të pasojave që vinë ndaj meje lidhur me këtë Deklaratë, në respektim të ligjit nr. 9121/2003, “Për mbrojtjen e konkurrencës” dhe ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar.
--

Kam përgatitur ofertën në mënyrë të pavarur, pa bërë marrëveshje apo pa rënë dakord me asnjë konkurrent tjetër¹.

Në veçanti, pa kufizuar si më lart, nuk kam pasur kontratë apo marrëveshje me ndonjë konkurrent me qëllim cënimin e konkurrencën, në lidhje me:

- a) çmimet;
- b) metodat, faktorët ose formulat e përdorura për llogaritjen e çmimit;
- c) qëllimin apo vendimin për të paraqitur apo jo një ofertë; ose,
- d) paraqitjen e një oferte që nuk i plotëson specifikimet e kërkesës për ofertë.

Nuk kam pasur marrëveshje apo kontrata me ndonjë konkurrent, me qëllim cënimin e konkurrencës, në lidhje me cilësinë, sasinë, specifikimet apo dërgesa të veçanta të produkteve apo shërbimeve të cilat lidhen me prokurimin në fjalë.

Kushtet e ofertës nuk u janë bërë të njohura dhe as nuk do t'u bëhen të njohura, me qëllim cënimin e konkurrencës, në çdo mënyrë qoftë, konkurrentëve të tjerë, para datës dhe kohës së hapjes zyrtare të ofertave, shpalljes fitues dhe lidhjes së kontratës, vetëm nëse kërkohet me ligj.

C: DEKLARATA

Mbi Konfliktin e Interesit

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se jemi të vetëdijshëm për sa vijon:

Konflikti i interesit është një situatë e konfliktit midis detyrës publike dhe interesit privat të një zyrtari, në të cilën ai / ajo ka interesa private direkte ose indirekte që ndikojnë, ose që mund të ndikojë ose që duket se ndikojnë në kryerjen e padrejtë të detyrave dhe detyrimeve publike.

Në përputhje me nenin 21, paragrafi 1, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005, kategoritë e zyrtarëve siç parashikohen në Kapitullin III, Seksioni II, që janë absolutisht të ndaluara të përfitojnë drejtpërdrejt ose indirekt nga nënshkrimi i kontratave midis një pale dhe institucionit publik janë:

- Presidenti i Republikës, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri, Ministrat, ose Zëvendësministrit, Deputetët, Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese, Gjyqtarët e Gjykatës së Lartë, Kreu i Kontrollit të Lartë të Shtetit, Prokurori i Përgjithshëm, Gjyqtarët dhe Prokurorët në nivelin e Gjykatës së Shkallës së Parë dhe Gjykatës së Apelit, Avokati i Popullit, Anëtarët e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Anëtarët e Këshillit të Lartë të Drejtësisë, Inspektori i Përgjithshëm i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit, Anëtarët e Enteve Rregullatore (Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, përfshirë Guvernatorin dhe Zëvendësguvernatorin; konkurrenca; telekomunikacioni; energjia elektrike; furnizimi me ujë; sigurimi; bonot; autoritetet e medias), sekretarët e përgjithshëm të institucioneve qendrore si dhe çdo zyrtar publik në çdo institucion publik pozicioni i të cilit është i barabartë me atë të Drejtorit i Përgjithshëm, drejtuesit e organeve të administratës publike që nuk janë pjesë e shërbimit civil.

Për nëpunësit civilë të nivelit të mesëm, sipas nenit 31 dhe zyrtarët sipas nenit 32 të kreut III, seksionit 2 të këtij ligji, ndalimi në paragrafin 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, siç përcaktohet këtu të zbatohet vetëm në rast të lidhjes së kontratave brenda fushës dhe

¹ Për qëllim të kësaj deklarate dhe ofertës së paraqitur, fjala "konkurrentë" nënkupton çdo operator tjetër ekonomik, të ndryshëm nga Ofertuesi, të paraqitur ose jo si bashkim operatorësh ekonomik, që: a) paraqesin një ofertë në përgjigje të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë, të bërë nga Autoriteti Kontraktor; b) është një ofertues i mundshëm, i cili bazuar në kualifikimin, aftësitë ose përvojat e tij, mundet të dorëzojë një ofertë në përgjigje, të Njoftimit të Kontratës dhe/ose të Ftesës për Ofertë.

territorit të institucionit dhe juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim do të zbatohet edhe kur pala në kontratë është një institucion varësie.

Kur zyrtari është kryetar bashkie ose nënkryetar i një bashkie ose komune, ose kryetar i një këshilli rajonal, anëtar i këshillit përkatës, ose një zyrtar i lartë i menaxhimit të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave private të zyrtarit, specifikuar këtu, do të zbatohet vetëm në rastin e lidhjes së kontratave, nëse ka, me bashkinë, komunën ose rajonin ku zyrtari ushtron një detyrë të tillë. Ky ndalim do të zbatohet gjithashtu kur pala në kontratë është një institucion publik në varësi të kësaj njësie (neni 21, paragrafi 2, Ligji Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e parashikuara në nenin 21, paragrafët 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, do të zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin, d.m.th. **bashkëshortin, bashkëjetuesin, fëmijët madhorë e prindërit e zyrtarit dhe të bashkëshortit dhe bashkëjetuesit.**

Unë jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të parashikuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 "Për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksioneve Publike", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore të miratuara në bazë të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimi dhe Kontrolli i Pasurive, si dhe Ligji Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik".

Në përputhje me to, unë deklaroj këtu se asnjë zyrtar publik, siç përcaktohet në Kapitullin III, Seksioni II të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk ka ndonjë interes privat, direkt ose indirekt, me personin juridik që unë përfaqësoj këtu.

D: DEKLARATA

Për zbatimin e dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës

Deklarata

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik_____lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Sqarime nëse vlerësohet e nevojshme _____

Pjesa III Kriteret e Përzgjedhjes/Kualifikimit

A: DEKLARATË

Në përputhje me specifikimet teknike dhe grafikun e realizimit të objektit të kontratës:

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, ne deklarojmë se plotësojmë të gjitha specifikimet teknike, siç udhëzohet në dokumentet e tenderit, dhe këtë e provojmë përmes certifikatave dhe dokumenteve të paraqitura me këtë deklaratë (nëse kërkohet nga Autoriteti Kontraktor), dhe marrim përsipër të realizojmë objektin në përputhje me Listën e mallrave dhe grafikun e lëvrimit të përcaktuar nga Autoriteti kontraktor.	Po [] Jo []

B: DEKLARATË

Për disponimin e punonjësve dhe makinerive të nevojshme (nëse kërkohen)

Deklarata	Përgjigje
Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se: Unë kam punonjësit e nevojshëm si dhe mjetet dhe makineritë për ekzekutimin e kontratës, siç përcaktohet në dokumentet e tenderit, dhe e vërtetoj këtë me dokumentacionin përkatës, të cilin do ta paraqes në kopje origjinale ose të noterizuar nëse fitoj, ose nëse më kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.	<u>Punonjës</u> Po [] Jo [] Nëse, po, numri i punonjësve: Profili i punonjësve — <u>Makineri e mjete</u> Po [] Jo [] Nëse po, të listohen me të dhënat konkrete:
Emri, Mbiemri _____ Firma _____ Vula _____ Data e dorëzimit të deklaratës _____	

Ju lutemi sigurohuni që:

- Secili pjesëmarrës i renditur në një bashkim operatorësh ekonomikë të paraqesë një Formular të veçantë të Vetëdeklarimit.
- Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, një Formular i veçantë i Vetëdeklarimit duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.
- Çdo vetdeklarim i pavërtetë/pasaktë nga ana e operatorëve ekonomikë jo vetëm që përbën shkak për skualifikimin nga procedura konkrete, por përbën shkak edhe për përjashtimin e tyre nga e drejta për të fituar kontrata publike deri në 3 vjet, sipas parashikimeve të ligjit për prokurimin publik.
- Operatorët ekonomikë që ofertojnë në procedurat e prokurimit të vetdeklarojnë në çdo rast informacionin e saktë që i korrespondon gjendjes së tyre faktike.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik për sa më sipër.

- Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikur i pari që të dorëzojë dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, si dhe dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike.
- Në procedurat e prokurimit me faza, ky dokumentacion i kërkohet të gjithë kandidatëve të kualifikuar në fazën e parë, përpara nisjes së afateve të ankimit.
- Ofertuesi i kualifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, për dokumentat e ofertës të ngarkuara në Sistemin e Prokurimit Elektronik duhet të dorëzojë dokumentat provuese, të cilat duhet të jenë në origjinal ose në kopje të njehsuara.
- Ndërsa, dokumentet provuese, që do të paraqiten për të provuar vetëdeklarimet e bëra, duhet të paraqiten në origjinal ose të njësuar me origjinalin dhe të provojnë gjendjen faktike të ofertuesit në kohën e ofertimit të tij.

Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe/ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

III.1.2. Në nenin 77, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: 1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:

- a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;
- b) gjendjen ekonomike dhe financiare;
- c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.

2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionale ose tregtarë.

III.1.3. Në pikat 1,2,5 të nenit 82 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar përcaktohet se: “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si provë paraprake** në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, **formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji.** Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik. Kur autoriteti ose enti kontraktor mund t'i marrë dokumentet mbështetëse duke u futur direkt në një bazë të aksesueshme të dhënash shtetërore, në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit përcaktohet edhe informacioni që kërkohet për këtë qëllim, siç është adresa në internet e bazës të të dhënave, çdo e dhënë identifikimi dhe, sipas rastit, në deklaratën e nevojshme për dhënien e pëlqimit. Operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure

prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

2. Në çdo kohë gjatë procedurës, autoriteti ose enti kontraktor mund t'u kërkojë ofertuesve dhe kandidatëve sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, kur kjo është e nevojshme për të qarrantuar zbatimin korrekt të procedurës.

5. Në procedurat e prokurimit me një fazë, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti ose enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari që të dorëzojë: a) dokumentet e paraqitura si pjesë e ofertës në rrugë elektronike, të cilat në kohën e dorëzimit pranë autoritetit ose entit kontraktor duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara të tyre;

Ndërsa në nenin 92/3 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”.

III.1.4. Në nenin 26 “Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit”, pikat 1, 2, 3, 6 dhe 7 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, **autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rrequlla.**

2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon:

- a) operatori ekonomik është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin ose sipas legjislacionit të posaçëm, në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) operatori ekonomik nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- c) personi/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, nuk është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 76, të LPP-së;
- ç) operatori ekonomik nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
- d) operatori ekonomik nuk është në proces falimentimi;
- dh) operatori ekonomik ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e taksave dhe tatimeve 1 të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas parashikimeve të pikës 2, të nenit 76, të LPP-së;
- e) operatori ekonomik ka shlyer të gjitha detyrimet e maturuara të energjisë elektrike, dhe përmbush kërkesat që rrjedhin nga legjislacioni i fushës në fuqi. Ky informacion kërkohet për operatorët ekonomikë, të cilët ushtrojnë veprimtarinë në territorin e Republikës së Shqipërisë;
- ë) operatori ekonomik nuk ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- f) operatori ekonomik ushtron aktivitetin në zbatim të kërkesave ligjore të legjislacionit mjedisor, social dhe të punës;

g) operatori ekonomik ka paraqitur ofertë të pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
gj) operatori ekonomik përmbush specifikimet teknike, sipas kërkesave të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor;

h) operatori ekonomik disponon fuqinë punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor (kur është rasti);

i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti;

j) informacion mbi subjektet, mbi kapacitetet e të cilave, operatori ekonomik do të mbështetet, nëse është rasti dhe nënkontraktorët e mundshëm, nëse është rasti;

k) operatori ekonomik ushtron aktivitetin konform kërkesave të legjislacionit në fuqi.

3. Informacioni i pasqyruar në formularin e vetëdeklarimit, i cili gjendet në një bazë të dhënash, ku autoriteti/enti kontraktor mund të aksesojë direkt këtë informacion dhe /ose dokumentin, duhet të shoqërohet me adresën përkatëse për këtë bazë të dhënash.

4. Për përmbushjen e detyrimit sipas këtij neni, operatorët ekonomikë mund të përdorin një formular vetëdeklarimi që është përdorur gjatë një procedure prokurimi të mëparshme, nëse informacioni që ajo përmban vazhdon të jetë i saktë dhe i vlefshëm.

5. Operatorëve ekonomikë nuk u kërkohet të dorëzojnë dokumente mbështetëse, kur autoriteti ose enti kontraktor që ka dhënë kontratën ose ka lidhur marrëveshjen kuadër, i ka këto dokumente.

6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shogëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Autoriteti/enti kontraktor pranon një dokument të lëshuar nga i njëjti institucion ose palë e tretë dhe që ka të njëjtin informacion me atë të paraqiturnë procedurën e zhvilluar në mënyrë elektronike.

Operatorët ekonomikë të huaj duhet të paraqesin dokumentet në formën e kërkuar nga legjislacioni në fuqi për njohjen e dokumentacionit të lëshuar në një shtet të huaj.

Për dokumentet që nuk lëshohen në vendin e origjinës, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë këtë fakt, përndryshe dokumentacioni do të konsiderohet i paparaqitur.

7. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime.

III.1.5 Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson, se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Autoriteti kontraktor është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi ndaj dhe përcaktimi i kriterëve të veçanta për

kualifikim dhe specififikimet teknike janë lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin dhe natyrën e kontratës së prokurimit.

Kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të kualifikimit, të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa dhe përsa kohë janë pranuar prej tyre.

Në pikën 1 dhe 6 të nenit 26 “*Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit*”, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*” i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “*Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla. 2. Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit përmban informacion dhe deklarimin, si më poshtë vijon: i) operatori ekonomik disponon mjetet dhe makineritë e nevojshme për ekzekutimin e kontratës, sipas kërkesave të autoritetit/entit kontraktor, kur është rasti; 6. Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.*

Nga verifikimi i dokumenteve standarde të publikuara nga autoriteti kontraktor konstatohet, se ky i fundit ka publikuar setin e dokumentave standarde për procedurën e prokurimit *Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*, sipas vendimit nr. 08, datë 05.10.2022, me ndryshimet përkatëse, konkretisht dhe të shtojcës 9 “*Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit*”, në të cilin konstatohen ndryshime thelbësore edhe në përmbajtje të tij.

III.1.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se për përmbushjen e kriterëve të Përgjithshme të Përzgjedhjes / Kualifikimit si edhe Shtojcës 9, , Operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F ka ngarkuar në SPE Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, të plotësuar nga verifikimi i të cilit konstatohen përputhje në formë edhe në përmbajtje me Shtojcën 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, publikuar në DST nga Autoriteti Kontraktor.

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F ka paraqitur Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit, të plotësuar në të gjitha seksionet si edhe në fund të çdo faqeje, të firmosur nga administratori i operatorit ekonomik i cili rezulton i njëjtë me formatin e ri me ndryshimet sipas vndimit sipërcituar i njëjtë me formularin e shtojcës 9 të DST-së.

Pretendimet e ankimuesit në lidhje me parregullsi të dokumentit, Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit nuk qëndrojnë.

III.2. Në lidhje me pretendimet e ankimuesit mbi mospërmbushje të Kritereve të Përgjithshme të Kualifikimit, me argumente:

*[...]Në ditën dhe orën e hapjes së ofertave, ka pasur **detyrime tatimore të papaguara dhe kontribute të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të papaguara**. Për këtë arsye, kërkojmë nga KSHA e AK dhe KPP, që përpara marrjes së një vendimi të arsyetuar përse i përket kësaj pike, të kërkojnë zyrtarisht një informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve. Gjithashtu, mendojmë që OE Energita Çekrezi., nuk ka paraqitur / dorëzuar në sistemin SPE të APP, një Vërtetim të vlefshëm, i cili vërteton shlyerjen e të gjitha **detyrimeve të faturave të energjisë elektrike, në përputhje me rregullat e prokurimit publik**. [...]*

Komisioni, me shkresën nr. 3048/3 prot., datë 19.11.2025, me objekt: Kërkesë për dërgim dokumentacioni, drejtuar Autoritetit Kontraktor, kërkoi:

[...]“Komisionit të Prokurimit Publik i lind nevoja të shqyrtojë dokumentacionin e plotë të dorëzuar në mënyrë shkresore pranë autoritetit tuaj kontraktor, në përmbushje të kritereve të përgjithshme për kualifikim, deklaruar me Shtojcën 9, Formulari përmbledhës i vetëdeklarimit, nga operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F, i renditur i pari.

Me qëllim vijimin e gjykimit të ankesës pranë KPP-së në përputhje me nenin 115 të LPP-së, Autoriteti Kontraktor, referuar nenit 26 Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet se: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin.” të dërgojë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, kopje, të njësuara me origjinalin të dokumentacionit të plotë të dorëzuar pranë autoritetit tuaj kontraktor, nga operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F.”[...]

III.2.1. Autoriteti Kontraktor me shkresën nr. 1343/36 prot, datë 21.11.2025, protokolluar me tonën me nr. 3048/4, datë 24.11.2025, përcolli pranë Komisionit, dokumentet provuese të cilat pasi i mori në shqyrtim konstaton, se janë paraqitur dokumentet si më poshtë vijon:

1. Shtojca 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit I plotësuar, firmosur dhe vulosur.
2. Ekstrakt i Regjistrimit Tregëtar për të dhënat e Subjektit.
3. Ekstrakt Historik i Regjistrimit Tregëtar për të dhënat e Subjektit.
4. Dokument nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Datë 01.10.2025, Vërtetim për personin juridik, “Energita Çekrezi” P.F, nuk rezulton të ketë proces penal themeli nga data 01.01.2025 deri më sot.,

5. Dokument nga Prokuria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, Datë 02.10.2025, Vërtetim, për subjektin “Energita Çekrezi” P.F, nuk rezulton të këtë procedim penal, të regjistruar në ngarkim të tij.
6. Dokument, Çertifikatë Regjistrimi, Personit të Tatueshëm Energita Çekrezi, Status Aktiv. Data e lëshimit 29.09.2025.
7. Dokument, nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve, Tiranë, Nr.T14149365. datë 29.09.2025. Vërtetim, rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datë 29.09.2025.
8. Fotokopje të Librezës së pagesave të Energjisë Elektrike.
9. Dokument, Letër Reference.
10. Dokument, Vërtetim për Xhiron e tre Viteve të Fundit.
11. Shtojca 1. Formulari i Ofertës Ekonomike.
12. Shtojca 3, Lista e Çmimeve të Artikujve.
13. Deklaratë, në zbatim të Kriterit 2.3.2, merr përsipër të gjitha Kërkesat Funksionale dhe Specifikimet Teknike. Nga administratori Energita Çekrezi
14. Deklaratë Garancie për përmbushje të kërkesave funksionale. Nga administratori Energita Çekrezi

Referuar, bazës ligjore, neni 26/6 i VKM-së 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Deklarimeve të Shtojcës 9 dhe Dokumentacionit provues të operatorit ekonomik, dorëzuar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit, rezulton se operatori ekonomik Energita Çekrezi P.F, nuk ka përcjellë pranë Autoritetit Kontraktor të gjitha dokumentet provuese, të cilat i ka deklaruar me shtojcën 9, Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit.

Konkretisht mungojnë:

- 1.Vërtetimi për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për Tatimpaguesin E-Sig 02/a.
- 2.Vërtetim Debie nga OSHE Group FSHU, mbi deturimet e energjisë elektrike.

Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi.

Për sa referuar më sipër, operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F, nuk ka paraqitur dokumentacion të saktë, deklaruar me shtojcën 9, dhe si rrjedhojë nuk përmbush kriteret e përgjithshme të kualifikim të publikuara nga autoriteti kontraktor në SPE.

Pretendimet e operatorit ekonomik ankimuesit qëndrojnë.

III.3. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik “Inpress” ShPK për mosparaqitje nga operatori “Energita Çekrezi” P.F, të Deklaratës, kërkuar në kriterin 2.3.2, të “Kapacitetet teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST, me pretendimin si vijon:

[...] Operatori ekonomik nuk ka paraqitur Deklaratat e kërkuara dhe përcaktuara në DST → Në pikën 2.3.2 “Kapaciteti Teknik”, të shtojcës 8, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit të DST përcaktohet se: “2.3.2. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë një deklaratë ku merr përsipër të gjitha Kërkesat Funksionale dhe Specifikimet Teknike të kërkuara nga AK.[...]”

Komisioni nga shqyrtimi i dokumenteve të ofertës depozituar në SPE si edhe dokumenteve provuese të përcjella nga Autoriteti kontraktor konstaton, se operatori ekonomik “Energita Çekrezi” P.F, ka përmbushur kriterin 2.3.2 duke plotësuar dokumentet si vijon:

1. Deklaratë, nga administratori Energita Çekrezi. Në zbatim të Kriterit 2.3.2, merr përsipër të gjitha Kërkesat Funksionale dhe Specifikimet Teknike. I firmosur dhe vulosur.
2. Deklaratë Garancie për përmbushje të kërkesave funksionale. Nga administratori Energita Çekrezi i firmosur dhe vulosur.

Përsa më sipër konstatuar pretendimet mbi mosplotësim të kriterin 2.3.2 nga operatori ekonomik Energita Çekrezi P.F, nuk qëndrojnë.

III.4. Në lidhje me pretendimet e tjera të ankimuesit “Inpress” ShPK, mbi parregullsi të dokumentacionit të operatorit ekonomik të kualifikuar “Energita Çekrezi” P.F, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon, se nuk do të merren në shqyrtim, pasi referuar gjykimit më sipër në pikën III.2 të këtij Vendimi, gjendja faktike dhe juridike e operatorit ekonomik “Energita Çekrezi” P.F, do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura në fjalë, e rrjedhimisht duke përmbushur interesin e ankimuesit.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Inpress” ShPK për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur e Thjeshtuar*”, me Nr. REF-62411-09-23-2025, me objekt: Materiale Promocionale për nevojat e shoqërisë Illyrian Guard Sh.A, me fond limit 1.487.833 Lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 06.10.2025 nga autoriteti kontraktor Illyrian Guard, Sh.A.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë ofertat duke skualifikuar ofertën e operatorit Energita Çekrezi P.F sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të njoftojë Komisionin mbi veprimet e ndërmarra në përputhje me këtë vendim.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Inpress” ShPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

